



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.404/11

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Lumni Sallauka, me sekretaren juridike Raxhije Emini, në çështjen juridike të paditësit KEK-Distrikti në Prizren, të cilin me autorizim e përfaqëson B. P. nga Prizreni, kundër të paditurës N. T. nga fshati Gj. Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqëson av. N. Q. nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimin e dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, me datën **24.09.2014**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditësit KEK– Distribucioni në Prizren.

II. DETYROHET e paditura N. T. nga fshati Gj. Komuna e Prizrenit, që në emër të kompenzimit të dëmit të shkaktuar për shkak të shfrytëzimit të pa autorizuar të energjisë elektrike, t'ia paguajë paditësit shumën prej 423.86 €, me kamatë vjetore e cila llogaritet për mjetet e afatizuara mbi 1 (një) vit në bankat komerciale në Kosovë, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në ditën e pagesës definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë të paditësit KEK–Distribucioni në Prizren, përtej shumës së aprovuar prej 1,947.97 €, **refuzohet** si e pabazuar.

A r s y e t i m

I autorizuari i paditësit B. P. gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se ngel pranë pohimeve të theksuara në padinë dhe kërkesëpadinë, duke propozuar që gjykata pas administrimit të provave, të njejtën ta aprovon si të bazuar. Gjithashtu ka kërkuar nga gjykata që ta obligoj të paditurin që të paguaj shumën e kërkuar si në padi me kamatë ligjore, nga data e parashtrimit të kësaj padie, ndërsa sa i përket ekspertizës ka kërkuar nga gjykata që ta refuzon për shkakë të sqarimeve të cekuara më herët. Po ashtu ka kërkuar shpenzimet për taksë gjyqësore në shumë prej 15 euro.

I autorizuari i të paditurës av. N. Q. nga Prizreni, në shqyrtimin kryesor deklaroi se e kundërshton pjesërisht kërkesë padinë e paditësit, duke theksuar se nëse pala paditëse pajtohet që të lidhë marrëveshje gjyqësore, atëherë është i

pajtimet që të paguajë shumën e caktuar në ekspertizë. Ndërsa e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit mbi shumën e aprovuar, pasi ka konsideruar se e njëjtat është e pabazë. Këtë sipas tij e ka vërtetuar edhe ekspertiza e ekspertit të elektroteknikës M. Gj.. Në fjalën e fundit ka kërkuar nga gjykata që pas vlerësimit të provave të administruara kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë pjesërisht në shumën e përmendur më lartë, ndërsa për pjesën tjetër ta refuzojë si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e këtyre provave: aktgjykimin penal P.nr.384/09 i dt. 03.05.2011 të Gjykatës Komunale në Prizren, faturën e datës 10.03.2009, rregulloren e paditëses për procedurën e identifikimit dhe parandalimit të shfrytëzimit të pautorizuar të energjisë elektrike të vitit 2009, ekspertizën e ekspertit të elektroteknikës M. Gj. të datës 13.07.2014, i cili ekspert është dëgjuar edhe në shqyrtimin kryesor.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjiqëse, provave të nxjera në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **pjesërisht është e bazuar**.

Nga aktgjykimi penal P.nr.384/09 i dt. 03.05.2011, i Gjykatës Komunale në Prizren, gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura është shpallur fajtores për veprën penale të vjedhjes (shfrytëzim i pautorizuar i energjisë elektrike) ku këtu paditëses i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 2.371.83 € (shumë e cekur në dispozitivin e këtij aktgjykimi) dhe për këtë vepër është dënuar me dënim me kusht.

Në ekspertizën e ekspertit të elektroteknikës ing. M. Gj. të datës 13.07.2014, ndër të tjera konstatohet se tek e paditura N. T. është hasur duke keqpërdorur energjinë elektrike pa njehësor dhe pa lejen e KEK-ut. Fatura për rikthimin e humbjeve për shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të pautorizuar është llogaritur duke bërë llogaritjen mbrapa për 6 muaj me fuqi të angazhuar për një muaj 1100 kwh dhe duke ja zbritur energjinë e faturuar gjatë asaj kohe, ndërsa vlera e faturës për rikthimin e humbjeve duhet të ishte 423.86 euro, e jo shuma të cilën e ka përcaktuar paditësja (më gjerësisht referoju ekspertizës së lartcekur dhe procesverbalit për shqyrtim kryesor të datës 24.09.2014, në të cilën është dëgjuar eksperti në fjalë, i cili ka sqaruar dhe arsyetuar në detaje mendimin e tij).

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartëcekura gjykatës i rezultoi se e paditura i ka borxh paditësit shumën prej 423.86 €, në emër të kompensimit të dëmit, për shfrytëzimin e energjisë elektrike në mënyrë të pautorizuar, të cilin fakt gjykata e vërtetoi nga aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prizren P.nr.384/09 i dt. 03.05.2011, i cili është bërë i plotfuqishëm, me të cilin e paditura N. T. është shpallur fajtores për keqpërdorim të energjisë elektrike, por edhe nga ekspertiza e ekspertit të elektroteknikës të përmendur më lartë, të cilës gjykata ja fali besimin e plotë, e paditura i ka shkaktuar dëm paditëses shumën e cekur më lartë. Pra shuma e tërësishme e të hollave që e paditura duhet të ja paguaj paditëses në emër të kompensimit të dëmit është 423.86 €, e jo siç ka pretenduar paditësja shumën prej 2.371.83 €. Edhe pala e

paditur shumën e gjykuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi nuk e ka kontestuar, më saktësisht i ka propozuar gjykatës që të njëjtën shumë ta aprovojë si të bazuar.

Me nenin 154 par. 1. të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), është paraparë se *“Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*. Në bazë të këtij principi pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar me dashje dhe nga pa kujdesia. Çështja e përgjegjësive subjektive është rregulluar në bazë të nenit 154 par. 1. dhe lidhur me nenin 158 të LMD. Në rastin konkret i padituri nuk i ka ofruar prova gjykatës që do të provonin se dëmi ndaj paditësit është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa me nenin 262 të po këtij ligji, është paraparë se *“kreditore në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë të përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Gjithashtu bazuar në nenin 14 të LPK-së në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësive penale të kryesit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilën e pandehura është shpallur fajtor.

Për detyrimin e të paditurit për të paguar kamatën vjetore, gjykata vendosi konform nenit 277 par.1 i LMD-së, meqenëse e paditura është vonuar në pagesën e detyrimit ndaj paditësit.

Gjykata vendosi si në pikën **IV** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e administruara, e veçanarisht ekspertizën e ekspertit të elektroteknikës M. Gj., rezultoi se shumica e kërkuar nga pala paditëse përtej shumës së aprovuar është e pabazuar, andaj edhe e njëjta është refuzuar si e pabazuar.

Gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale, duke marr parasysh këtu faktin se paditësja ka pasur pjesërisht sukses në fitimin e këtij kontesti, ndërsa një pjesë të shpenzimeve të procedurës janë paguar nga mjetet e gjykatës (shpenzimet e ekspertizës), për shkak se e paditura nuk ka pasur mjete financiare për ta paguar (rast social).

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat e tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritorë të kësaj çështje juridike kontestimore.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 17 dhe 262 të LMD-së, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.404/11, datë 24.09.2014

Sekretare juridike,
Raxhije Emini

Gjyqtari,
Lumni Sallauka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur, ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.